

(<https://top-channel.tv/>)

AKTUALITET ([HTTPS://TOP-CHANNEL.TV/ARTIKUJ/VENDI/AKTUALITET/](https://top-channel.tv/artikuj/vendi/aktualitet/))

KRYESORE ([HTTPS://TOP-CHANNEL.TV/ARTIKUJ/KRYESORE/](https://top-channel.tv/artikuj/kryesore/))

TË FUNDIT ([HTTPS://TOP-CHANNEL.TV/ARTIKUJ/TE-FUNDIT/](https://top-channel.tv/artikuj/te-fundit/))

Shqipëria zgjohet nën terror/ Vrasje në Lezhë, plagoset një 6-vjeçar në Bulqizë

□ 19/06/2019 08:20



(https://www.facebook.com/app_id=1715618661991455/channel.tv/2019/06/19/shqip-zgjohet-nen-terror-vrasje-ne-lezhe-plagoset-nje-6-vjecar-ne-bulqize/&redirect_uri=https://channel.tv/2019/06/19/shqip-zgjohet-nen-terror-vrasje-ne-lezhe-plagoset-nje-6-vjecar-ne-bulqize/) □

([whatsapp://send?text=https://top-channel.tv/2019/06/19/shqip-zgjohet-nen-terror-vrasje-ne-lezhe-plagoset-nje-6-vjecar-ne-bulqize/](https://www.whatsapp.com/send?text=https://top-channel.tv/2019/06/19/shqip-zgjohet-nen-terror-vrasje-ne-lezhe-plagoset-nje-6-vjecar-ne-bulqize/)) □

(<https://twitter.com/intent/tv/text=Shqip%C3%ABria+zgjojvje%C3%A7ar+n%C3%AB+Bulqizetop-channel.tv/2019/06/19/shqip-zgjohet-nen-terror-vrasje-ne-lezhe-plagoset-nje-6-vjecar-ne-bulqize/>)



Shqipëria zgjohet nën breshërinë e armëve, ku është shënuar një vrasje në Lezhë dhe plagosur rëndë një fëmijë në Bulqizë.

Download PPT Infograph

Lifetime Access to Over 150
Premium infographics. Unlimited
Downloads

Ngjarja e parë ka ndodhur në Njësinë Administrative Martanesh, Bulqizë, pas konfliktit me armë mes dy familjeve.

Sipas policisë një person ka qëlluar me armë zjarri automatik drejt shtëpisë ku ndodhej dhe për pasojë plumbat kanë kapur fëmijën 6 vjeç, i cili është plagosur rëndë. Aktualisht 6- vjeçari ndodhet në spitalin e Peshkopisë.

Pak orë pas plagosjes së vogëlushit, policia ka bërë të mundur lokalizimin dhe arrestimin e autorit të krimit. Në njoftimin zyrtar të policisë, thuhet se rreth orës 01:15, të mëngjesit të sotëm, janë konfliktuar në një lokal për motive të dobëta shtetasit Jetmir Koxherri, H. Rr. dhe Sh. P. Pas kësaj, Jetmir Koxherri është larguar nga lokali dhe ka marrë një armë zjarri për të qëlluar në drejtim të banesës të shtetasit H. Rr, ku për pasojë ka mbetur i plagosur një fëmijë i mitur, i cili po merr ndihmë mjekësore në spitalin e Traumës në Tiranë.

Policia ka shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes dhe falë veprimeve të shpejta hetimore, në orët e mëngjesit, është bërë kapja e autorit të ngjarjes Jetmir Koxherri, 27 vjeç, banues në Krastë, si dhe sekuestrimi i armës së krimit. Grupi hetimor vijon hetimet në vendngjarje.

Vrasja në Lezhë

Pak minuta më vonë u raportua për vrasjen në Lezhë, ku nga të dhënat paraprake thuhet se viktimë është kryeplaku i fshatit Merqi, i identifikuar si Gjini Marku. Policia ende nuk ka një pistë të shkaqeve të vrasjes, por në një komunikatë zyrtare raportoi se vrasja dyshohet të ketë ndodhur për motive të dobëta.

“Në fshatin Merqi, Lezhë dyshohet pas një konflikti për motive të dobëta është vrarë me armë zjarri shtetasi Gj. M. Policia ka shkuar menjëherë në vendngjarje ku ka bërë identifikimin e autorit të dyshuar i cili është shtetasi T. Gj., mik në familjen e viktimës, nga Fshati Kashnjet Lezhë. Policia është vënë në ndjekje të autorit dhe po vijon puna për kapjen e tij. Në vendngjarje grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes”, thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.